




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.54/24
Datë: 18.06.2024

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 26, 27, 35, 36 dhe neni 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 18.06.2024, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

Me të cilin,

I. Konstaton se, nuk ka kushte për fillimin e procedurës për vlerësimin e Përqendrimit sipas neni 36 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndaj ndërmarrjeve, ARD Holding L.L.C. dhe Fati Security Sh.P.K.

II. Autoriteti, hodhi poshtë Kërkesën për lejinin e përqendrimit të propozuar.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 03.05.2024, me Nr. Prot. 71/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me blerjen e propozuar të aseteve, pajisjeve në depo dhe atyre të instaluara dhe infrastrukturës, elementeve përcjellëse, klientëve dhe veturave, nga ndërmarrja e cila operon në sektorin e telekomunikimeve dhe audiovizive ARD Holding L.L.C., (blerës) mbi ndërmarrjen Fati Security Sh.P.K., (targeti).

Objekti i çështjes:

Vlerësimi i Njoftimit për Lejinin e Përqendrimit

Baza ligjore:

Sipas, neni 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pjesëmarrësit në përqendrim duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose

1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm.

2. Qarkullimi i pjesëmarrësve në përqendrim, llogaritet sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprinë vitit të përqendrimit. Nëse parashtuesit nuk kanë arritur të mbyllin raportet financiare vjetore para se të parashtrojnë kërkesën për lejimin e përqendrimit, qarkullimi i pjesëmarrësve llogaritet sipas raporteve financiare të vitit të fundit financiar, për të cilin janë mbyllur raportet financiare.

Pas shqyrtimit të Raporteve Financiare, marrë për bazë qarkullimin e palëve në Kosovë, për vitin financiar që i paraprin vitit të përqendrimit, bazuar në nenin 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., **nuk përmbushet detyrimi për të kërkuar lejimin e Përqendrimit.**

Poashtu bazuar në paragrafin 6 të nenit 36, Autoriteti ka konstatuar se, nuk janë përmbushur kriteret e lartë cekura, lidhur me detyrimin për të njoftuar përqendrimin, i cili ka të bëjë me blerjen e propozuar të aseteve.

Propozuesi i kërkesës, për Përqendrim:

ARD Holding L.L.C., me adresë të regjistruar në Qendra Tregtare Blaku Zahir Pajaziti, 11000 – Podujevë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 811509324. Kompania ofron shërbime të aktiviteteve të telekomunikimit kabllor – si aktivitet primar të saj, shtrirjen e sistemit kabllorë të fibrës optik, për të krijuar qasje në internet brezgjere.

ARD Holding, aktualisht është kryesisht aktive, në ofrimin e shërbimeve të qasjes në internet brezgjere dhe televizionit kabllor. Përkitazi me këtë, ARD Holding ofron shërbime të qasjes në internet për qytetarët dhe bizneset në të gjitha pikat ku operon, transmetimin e programeve televizive, publicitetin përmes mediave dhe të tjera. Kompania ka shtrirje nëpër disa qytete të Kosovës si; Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Klinë, Obiliq, Drenas, Malishevë.

Dorëzimi i shërbimit kryhet nëpërmjet abonimeve të cilat realizohen për konsumatorët në pikat e shpërndara në qendrat si më lartë, përfshirë fshatrat përreth.

Mbi:

Fati Security Sh.P.K., me adresë të regjistruar në Rruga Mentor Morina, nr.6 – Gillogovc, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 811290238, e cila ushtron veprimtari në fushën e aktivitetit të telekomunikimit kabllorë. E njëjta ofron shtrirjen e rrjetit optik, në disa lagje të komunës, me synimin që atë të shtrijë rrjetin në të gjitha lagjet e qytetit dhe fshatrat përreth.

Komisioni, ka vlerësuar kërkesën e palëve, andaj lidhur me këtë, konkludon se të njëjtat nuk janë subjekt i detyrimit të Njoftimit për Përqendrim.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURENCËS
Komisioni

Neime Binaku - Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva